



FAKULTETI I EDUKIMIT
UNIVERSITETI I
PRISHTINËS

POLITIKA PËR PARANDALIMIN E NGACMIMEVE DHE KRIJIMIN E MJEDISEVE TË SIGURTA

Miratuar nga Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Edukimit
me datë: 29 tetor 2024

PARATHËNIE

FAKULTETI I
EDUKIMIT

Ky dokument është detyruar për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik të Fakultetit të Edukimit dhe përcakton në një anë përkushtimin e institucionit ndaj krijimit të ambienteve cilësore dhe të sigurta ndërsa në anën tjetër vendos mekanizmat shtesë për vetëdijësimin mbi dhe parandalimin e diskriminimit dhe ngacmimeve në mjediset e fakultetit dhe proceset relevante të realizimit të proceseve arsimore. Dokumenti poashtu paraqet në formë të elaboruar strukturat dhe proceset e raportimit dhe reagimit, si dhe plane të menaxhimit të krizave e shqetësimeve që mund të ngriten nga studentët e personeli i FEdu.

Në emër të Fakultetit të Edukimit, Task Forca për Krijimin e Ambienteve Miqësore dhe Cilësore Akadematike, e themeluar nga Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Edukimit me datë 07 Maj 2024, nën koordinimin e Zyres së Prodekanit për Shkencë dhe Zhvillim, është përgjegjëse për ndërmarrjen e veprimeve vetëdijësuese dhe parandaluese dhe sigurohet se institucioni përgjigjet ndaj të gjitha pretendimeve dhe lajmërimeve për diskriminim dhe ngacmim duke marrë masa për t'u siguruar që secili pretendim të trajtohet sipas Kodit Etik të Universitetit të Prishtinës dhe procedurave disiplinore për stafin akademik dhe për studentët, Rregullores për parandalimin e ngacmimeve në Universitetin e Prishtinës, Rregullores së Komunikimit dhe kërkesave tjera ligjore në fuqi.

Kur Task Forca merr dijeni për një ankesë se një anëtar i komunitetit të saj mund të jetë subjekt ose i prekur nga sjellje diskriminuese dhe/ose ngacmuese, Task Forca do të marrë veprime të menjëhershme, duke përfshirë adresimin e çështjes tek instancat relevante si Dekani i Fakultetit, Komisioni Disciplinor dhe Këshilli i Etikës për të ndaluar diskriminimin dhe/ose ngacmimin.

Krijimi i Task Forcës dhe kësaj politike nuk shihet si zëvendësim i mekanizmave në fuqi. por si një mekanizëm dhe përpjekje shtesë për të fuqizuar rregullat dhe mekanizmat shtesë por edhe për të avancuar ndërgjegjësimin dhe praktikën aktuale në institucion lidhur me diskriminimin dhe sjelljet e tjera joetike e joprofesionale.

PARIMET UDHËHEQËSE

Duke theksuar qëndrimin “zero tolerancë” ndaj sjelljeve që krijojnë mjedis jomiqësor për studentët, stafin akademik dhe stafin administrativ, si dhe sjelljeve si ngacmimi, ngacmimi seksual, diskriminimi, cënimi i integritetit personal, shpifja, ofendimi apo sjelljeve tjera joetike, si dhe duke reflektuar vlerat institucionale të Fakultetit, Fakulteti i Edukimit lanson Politikën e vet kundër diskriminimit dhe ngacmimit, përmes së cilës zotohet për masa proaktive për parandalimin e sjelljeve joetike dhe joprofesionale në mjediset e fakultetit si dhe avokimin dhe avancimin e vlerave njerëzore duke përfshirë respektin, të drejtat e njeriut dhe trajtimin dinjitoz të secilit anëtar të komunitetit të Fakultetit të Edukimit.

Politika e Fakultetit të Edukimit ka për qëllim garantimin e mjediseve të sigurta dhe profesionale për punë dhe mësim dhe ndalon çdo formë të diskriminimit, shkeljes së integritetit dhe ngacmimit dhe zbatohet për të gjithë anëtarët e komunitetit të Fakultetit.

Fakulteti i Edukimit është i përkushtuar për të krijuar një mjedis arsimor gjithëpërfshirës, të sigurt, respektues dhe të lirë nga diskriminimi dhe ngacmimi për të gjithë studentët, stafin akademik, dhe stafi administrativ.

Fakulteti i Edukimit dënon fuqimisht çdo formë të diskriminimit dhe ngacmimit, qoftë brenda apo jashtë institucionit të vet, dhe bën përpjekje të vazhdueshme për të siguruar që ekzistojnë mekanizmat e duhur për vetëdijësimin, parandalimin, raportimin dhe reagimin ndaj diskriminimit dhe ngacmimit. Diskriminimi, ngacmimi, dhe keqtrajtimi i çdo forme janë rreptësisht të ndaluara dhe nuk do të tolerohen.

Fakulteti i
Edukimit

FUSHËVEPRIMI

Kjo politikë zbatohet për të gjithë anëtarët e Fakultetit të Edukimit, përfshirë por jo vetëm:

- Studentët (në nivelin universitar/ pasuniversitar)
- Anëtarët e stafit akademik
- Stafin administrativ dhe mbështetës
- Studiuesit dhe ligjëruesit vizitorë
- Ofruesit e shërbimeve
- Çdo individ tjetër i lidhur profesionalisht me Fakultetin e Edukimit



Termet e përgjithshëm dhe kuptimet e tyre janë të definuara në Rregulloren për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi seksual dhe ngacmimi në Universitetin e Prishtinës. Kjo politikë rifuqizon përkufizimin e specifikuar në këtë rregullore dhe i detajon më tutje.

Karakteristikat e mbrojtura janë ato tipare personale, karakteristika dhe/ose besime që përcaktohen nga ligji në fuqi si të mbrojtura nga diskriminimi dhe/ose ngacmimi. Ato përfshijnë racën, bindjet, ngjyrën, gjininë, shtatzëninë dhe kushtet e lidhura me të, identitetin ose shprehjen gjinore, moshën, origjinën kombëtare, prejardhjen, fenë, aftësinë fizike ose mendore, statusin martesor ose të bashkëjetesës, orientimin afektiv ose seksual dhe/ose karakteristika të tjera të mbrojtura me ligjet në fuqi.

Diskriminimi është trajtimi i padrejtë ose i pabarabartë i një individi ose grupi, dhe trajtimi i pafavorshëm i një individi/grupi bazuar në një karakteristikë të mbrojtur. Shembuj të sjelljes që mund të përbëjnë diskriminim nëse bazohen në një karakteristikë të mbrojtur përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Veçimi ose trajtimi i një individi në mënyrë të pafavorshme (p.sh., disiplinë më e ashpër, notë më e ulët) për shkak të një karakteristike të mbrojtur;
- Mospranimi ose refuzimi për të angazhuar ose pranuar një individ për shkak të një karakteristike të mbrojtur;
- Mospërfshirja, neglizhimi apo keqtrajtimi bazuar në një karakteristikë të mbrojtur.

Ngacmimi nënkupton çfarëdo forme të sjelljes së padëshiruar mbi bazat e karakteristikave të mbrojtura, që ka për qëllim apo pasojë prekjen apo shkeljen e dinjitetit të një personi dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, degradues, nënçmues apo fyes. Për më tej, sipas kësaj politike ngacmimi është edhe sjellje verbale ose fizike e padëshiruar që i drejtohet një personi bazuar në një karakteristikë të mbrojtur, kur këto sjellje cenojnë dinjitetin e një personi, kanë efektin e ndërhyrjes së padrejtë në përvojën arsimore, kushtet e punës apo mësimin të një individi duke krijuar një mjedis frikësues, armiqësor ose fyes. Ngacmimi mund të jetë verbal, joverbal, fizik, seksual ose psikologjik. Përkufizimet e këtyre formave të ngacmimit detajohen në Rregulloren e UP-së. Shembuj të sjelljes që mund të përbëjnë ngacmim nëse bazohen në një karakteristikë të mbrojtur përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Shaka ose komente të padëshiruara rreth një karakteristike të mbrojtur ligjërisht (p.sh., shaka gjinore, seksuale, raciale ose fetare);
- Shfaqjen e posterëve ose fotografive negative ose fyese për një karakteristikë të mbrojtur ligjërisht;
- Të gjitha komunikimet, përfshirë edhe ato të transmetuara elektronikisht, si përmes e-mail-it, telefonit ose zërit të regjistruar, mesazheve me tekst, rrjeteve sociale ose përdorimeve të tjera të internetit, që shkelin këtë politikë.
- Dërgimin e letrave sugjestive, shënimeve, emailave me përmbajtje të natyrës seksuale; barsoletat dhe anekdotat seksuale, komentet verbal seksuale, dhe gjestet tjera të natyrës seksuale.

Abuzimi (keqtrajtimi) është çdo veprim që shkakton ose kërcënon të shkaktojë dëm fizik, emocional ose psikologjik ndaj një individi tjetër. Abuzimi mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në dhunë fizike, sulme verbale, ngacmim dhe manipulim psikologjik.

Shkelja e dinjitetit përcaktohet si veprim, i cili zvogëlon vetërespektin e personit, duke e vendosur atë në pozitë inferiore dhe në varësi; trajton personin si instrument apo si mjet për arritjen e qëllimit dhe interesit; zvogëlon vlerën, e cila karakterizon çdo person si anëtarë të barabartë dhe me dinjitet; dhe/apo privon personin nga vlerat e tij/saj njerëzore.

Shkelja e privatësisë është çdo veprim që i jep një personi ose grupi qasje të paautorizuar në informacionin personal ose të dhënat e individëve, duke shkelur kështu të drejtën e individëve për të mbajtur informacionin e tyre të ndjeshëm dhe privat. Kjo përfshin, por nuk kufizohet në:

- Zbulimi i informacionit personal pa pëlqimin e individit, siç është adresa, numri i telefonit, rrjetet sociale dhe/ose të dhënat tjera personale.
- Shpërndarja e paautorizuar e të dhënave të ndjeshme që lidhen me një karakteristikë të mbrojtur, siç janë informacionet për jetën, orientimin seksual, ose besimin fetar.
- Monitorimi i aktiviteteve të individëve pa informacionin ose pëlqimin e tyre, si për shembull, ndjekja e komunikimeve elektronike (e-mail, mesazhe), mediave sociale ose aktiviteteve tjera online.

Detyrimi është një veprim që i imponon një individ ose grupi të kryejë një veprim të caktuar, edhe nëse ai veprim është në kundërshtim me dëshirat, vullnetin ose parimet e tyre. Ky koncept përfshin:

- Një situatë ku një individ detyrohet të veprojë në një mënyrë të caktuar ose të kryejë një detyrë që nuk i takon, duke u bërë objekt i presionit ose kërcënimeve, të cilat mund të jenë fizike, emocionale, ose psikologjike.
- Situatat ku një individ është i detyruar të përfshihet në aktivitete që shkelin rregullat ose normat e përcaktuara nga institucioni, përfshirë presionin për të pranuar ose toleruar sjellje të papranueshme.
- Një formë detyrimi ku individët përdorin ndikimin ose pushtetin e tyre për të bërë që të tjerët të veprojnë në mënyrë që ata nuk e duan ose nuk e kanë obligim, duke krijuar një mjedis kërcënues apo frikësues.

Veprim hakmarrës përcaktohet si frikësim, kërcënim, detyrim, diskriminim ose veprim i pafavorshëm arsimor ose punësimi. Në varësi të rrethanave të përmendura më sipër, veprimet hakmarrëse mund të përfshijnë (por nuk kufizohen në):

- Veprim hakmarrës në notim
- Veprim hakmarrës në lidhje me pjesëmarrjen në një aktivitet arsimor
- Ndërhyrja e padrejtë me karrierën akademike ose profesionale të një individ tjetër
- Përfshirja në sjellje që përbën përndjekje, ngacmim ose sulm
- Përpjekja për të angazhuar të tjerët në veprime hakmarrëse në emër të dikujt tjetër.

Komunikimi joprofesional dhe fyes manifestohen në forma të ndryshme – të verbalizuara, të shkruara, ose fizike – dhe ndikojnë negativisht në marrëdhëniet ndërpersonale, integritetin personal, dhe mjedisin e punës ose të mësimi. Këto sjellje mund të shfaqen në një gamë të gjerë veprimesh, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në situatat e mëposhtme:

- Shaka ose komente fyese: Kjo përfshin çdo formë humori të papërshtatshëm ose komente të padëshiruara që përqendrohen në karakteristika personale si gjinia, raca, etnia, religjioni, orientimi seksual, moshë, ose aftësitë fizike dhe mendore. Për shembull, përdorimi i stereotipeve për të bërë shaka për një grup të caktuar ose komentet për pamjen e dikujt, mund të krijojnë një atmosferë që ndikon në ndjenjën e respektit dhe barazisë.
- Komente mbi pamjen, gjininë ose seksualitetin: Këto përfshijnë komente që sulmojnë drejtpërdrejt pamjen fizike të një individi, p.sh., komentet për peshën, lartësinë, ose mënyrën e veshjes. Veçanërisht, çdo koment që ngacmon ose zhvlerëson dikë bazuar në gjininë ose orientimin seksual të tij/saj është fyes dhe i papranueshëm. Këto lloj sjelljesh krijojnë një mjedis ku individët ndihen të pasigurt dhe të pavlerësuar.
- Degradimi Verbal: Përdorimi i gjuhës ose frazave që kanë për qëllim të fyejnë ose të nënçmojnë një person në prani të të tjerëve ose privatisht. Përfshin edhe sulme verbale ose ndonjë formë tjetër komunikimi që ka për qëllim të ulë një person në prani të të tjerëve, duke e vendosur atë në një pozicion inferior. Degradimi verbal mund të jetë në formën e thirrjes me emra ofendues, përdorimit të epiteteve ose ofendimeve që synojnë të zvogëlojnë ose poshtërojnë dinjitetin e një individi, apo edhe komenteve seksuale.
- Komente e komunikime të tjera me shkrim ose gojë që kalojnë parimet e një komunikimi profesional duke bërë palën tjetër të ndihet jo i respektuar ose të ofenduar.

Kjo politikë synon të:

- parandalojë rastet e ofendimit, diskrimimit dhe ngacmimit në hapësirat dhe programet e Fakultetit.
- bëjë anëtarët e komunitetit të vet të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe rolin e tyre aktiv në mbrojtjen e mirëqenies së vetes dhe të tjerëve.
- informojë anëtarët e komunitetit të vet për procedurat përkatëse (vetëdijësim, parandalim, raportim, reagim).
- inkurajojë anëtarët e komunitetit të vet për të avokuar, raportuar, reaguar ndaj shkeljeve të kësaj politike.
- të nxisë diskutime të hapura mbi çështjet e diskrimimit dhe ngacmimeve në mbledhjet dhe takimet në të gjitha programet dhe mes të gjithë akterëve
- vendosë kanale raportimi të drejta, të sigurta dhe transparente në të gjitha llojet e shkeljeve.
- krijojë një rrjet aktiv të mbrojtjes në mënyrë që të gjithë anëtarët e komunitetit të jenë të sigurt dhe të mbrojtur.
- krijojë një ambient ku secili ndihet i vlerësuar, respektuar dhe sigurt.

Fakulteti ndalon shprehimisht veprimet hakmarrëse ndaj çdo anëtari të komunitetit universitar që me ndershmëri:

- (1) dorëzon një raport, ankesë ose kërkesë në bazë të kësaj politike (ose me një entitet të jashtëm);
- (2) kundërshton në mënyrë të arsyeshme një veprim që besohet të përbëjë një shkelje të kësaj politike;
- (3) merr pjesë në hetimet, shqyrtimet e përputhshmërisë ose procedurat disiplinore të Fakultetit/Universitetit sipas kësaj politike.

Për këtë të fundit, Task Forca luan rol këshilldhënës për menaxhmentin dhe këshillin e fakultetit.

IMPLIKIMET PËR FAKULTETIN

FAKULTETI I
EDUKIMIT

Çfarë bëjmë ne?

Ndërgjegjësimi

Rritja e ndërgjegjësimit mes studentëve, stafit akademik dhe administrativ për diskriminimin dhe ngacmimin dhe rreziqet e lidhura. Kjo përfshin zhvillimin e seminareve informative, shpërndarjen e materialeve ndërgjegjësuese dhe integrimin e diskutimeve mbi mbrojtjen nga ngacmimi dhe diskriminimi në kurset dhe programet përkatëse.

Parandalimi

Zhvillimi dhe shpërndarja e burimeve dhe praktikave më të mira për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi dhe ngacmimi. Kjo mund të përfshijë sesione trajnimi mbi njohjen e rreziqeve të mundshme, krijimin e mjediseve të sigurta dhe promovimin e ndërveprimeve pozitive në kontekste akademike ose aktivitete komunitare.

Raportimi

Krijimi, zbatimi dhe komunikimi i një procedure të qartë dhe të qasshme për raportimin e diskriminimit dhe ngacmimit të dyshuar. Sigurimi që të gjithë anëtarët e institucionit të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre për të raportuar shqetësimet dhe ofrimi i kanaleve të ndryshme për raportimin e incidenteve në mënyrë konfidenciale.

Reagimi

Krijimi i protokoleve për të siguruar që të merren masa të shpejta dhe efektive kur dyshohet ose raportohet ndonjë shqetësim. Kjo përfshin trajnimin e stafit se si të reagojnë ndaj raportimeve, koordinimin me organet e tjera të UPSë dhe shërbimet për mbrojtjen dhe ofrimin e mbështetjes për individët e prekur.

Qëllimi: Të edukohen dhe sensibilizohen studentët dhe stafi mbi diskriminimin, abuzimin, dhe efektet negative të tyre në ambientin arsimor qoftë në raportet student-staf, student-student, apo staf-staf.

Zhvillimi i një kulture të hapur dhe të përgjegjshme në institucion është thelbësore për mbrojtjen e stafit dhe studentëve. Si institucione arsimore dhe si individë, ne inkurajojmë guximin që të thyejmë heshtjen dhe tabutë rreth çështjeve të ngacmimit dhe diskriminimit.

Është thelbësore të mirren parasysh konsideratat bazë të mëposhtme:

- Të gjithë ata që janë të lidhur me Fakultetin e Edukimit duhet të kuptojnë ngacmimin dhe diskriminimin në të gjitha implikimet e tij. Fakulteti ofron mundësi të rregullta për të diskutuar këto çështje në seanca ndërgjegjësuese, takime, diskutime me stafin dhe studentët. Kjo përfshin organizimin e seminareve dhe punëtorive për të informuar stafin dhe studentët mbi format e diskriminimit, abuzimit dhe ndikimet e tyre; fushatat e ndërgjegjësimit për të promovuar respektin dhe tolerancën në fakultet; shpërndarjen e broshurave dhe materialeve informuese mbi politikën e Fakultetit dhe të drejtat e individëve.
- Fakulteti ofron mundësi të rregullta për të gjithë studentët që të shprehin shqetësimet e tyre, në mënyrë individuale përmes Qendrës Këshilluese të themeluar në Fakultet, në mënyrë që çdo shqetësim për mbrojtjen të dëgjohet dhe të trajtohet.
- Fakulteti krijon hapësira transparente për takime, diskutime dhe konsultime mes të gjitha palëve.
- Roli dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e studentëve dhe stafit janë të përcaktuara qartë dhe të komunikuar përmes Rregullores së Universitetit për parandalimin dhe mbrojtjen nga ngacmimi në Universitetin e Prishtinës, Rregulloret për procedurat disiplinore si dhe Kodin Etik të stafit akademik.
- Fakulteti shënon ditët ndërkombëtare që theksojnë barazinë dhe të drejtat e njeriut
- Të gjithë të punësuarit dhe studentët pranojnë nga fakulteti një kopje të shkruar të politikës së mbrojtjes së studentëve dhe stafit dhe e njëjta është e qasshme në formë publike.

Qëllimi: Të vendosen mekanizma dhe struktura që parandalojnë incidentet e diskriminimit dhe abuzimit në programet e Fakultetit të Edukimit.

Për të parandaluar diskriminimin dhe ngacmimin e stafit dhe studentëve, ne krijojmë dhe ruajmë një mjedis që promovon vlerat thelbësore të Fakultetit të Edukimit. Një gamë e gjerë veprimesh mund të mbështesin këtë qëllim. Fokus kryesor është të dëgjojmë me kujdes zërin e studentëve dhe stafit, t'i marrim seriozisht pikëpamjet e tyre, t'i inkurajojmë të marrin pjesë në diskutimet mbi çështjet e mbrojtjes dhe t'u ofrojmë mundësi për të ndërtuar marrëdhënie të bazuara në besim. Është e qartë se diskriminimi dhe ngacmimi kanë më pak gjasa të ndodhin brenda një konteksti që promovon vetëdijësimin, parandalimin dhe pjesëmarrjen e të gjithëve në të gjitha nivelet.

Hapat parandalues përfshijnë si vijon:

- **Themelimi dhe funksionimi i Task Forcës** që do të monitorojë zbatimin e politikave dhe të rekomandojë ndryshime të nevojshme. Ndërgjegjësimi, parandalimi dhe aktivitetet e ndërlidhura me këto dy shtylla, planifikohen në baza vjetore dhe monitorohen nga Task Forca e Fakultetit të Edukimit.
- Me rastin e procedurave të përzgjedhjes dhe rekrutimit të stafit, Fakulteti bën verifikim të historisë së mëparshme për stafin akademik dhe bashkëpunëtorët përmes verifikimit të referencave.
- Ndërgjegjësimi i stafit, studentëve dhe bashkëpunëtorëve për atë se çdarë paraqet një praktikë joadekuate e që është në kundërshtim me këtë politikë dhe kodet e rregulloret në fuqi.
- Studentët, stafi i sapopunësuar dhe bashkëpunëtorët do të pajisen me një orientim lidhur me këtë politikë gjatë muajit të parë të angazhimit të tyre.
- Mbrojtja e stafit dhe studentëve do të jetë një temë e rregullt në takimet dhe diskutimet në fakultet, dhe do të ofrohen trajnime mbi identifikimin dhe parandalimin e situatave të diskriminimit dhe ngacmimit, dhe trajnim për menaxhimin e situatave konfliktuale dhe promovimin e një mjedisi të sigurt.
- Studentët do të kenë mundësinë të marrin rol aktiv në mbrojtjen e tyre. Ata inkurajohen të marrin pjesë në të gjitha çështjet që prekin jetën e tyre dhe janë të përfshirë në diskutimet për të drejtat e tyre.
- Të gjithë studentët do të kenë qasje në shërbimet e këshillimit kur është e nevojshme përmes Qendrës Këshilluese.
- Task Forca do të organizoj anketa anonime vjetore dhe ad-hoc për të ofruar edhe një mundësi shtesë për lajmërim apo raportim.

Qëllimi: Të sigurohet që të gjitha incidentet e diskriminimit dhe abuzimit të raportohen në mënyrë të sigurt dhe anonime, me mbrojtjen e plotë të raportuesve.

Raportimi dhe Reagimi ndaj shkeljeve eventuale është i rregulluar me Rregulloren për parandalimin e ngacmimeve në Universitetin e Prishtinës, megjithatë FEdu merr seriozisht të gjitha shqetësimet e ngritura nga studentët dhe stafi, qoftë në Fakultetin e Edukimit apo në programe të tjera të ndërlidhura, dhe merr masa të përshtatshme, konform rregullores së UP-së. Rregullorja përcakton dhe zbaton procedura të qarta për raportimin dhe reagimin ndaj shqetësimeve, duke përfshirë linjat e brendshme të komunikimit, dhe përcakton rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë personave të përfshirë.

Përgjegjësia për raportim: Studentët, stafi akademik dhe administrativ që vërejnë sjellje që janë në mospërputhje me këtë politikë apo me rregulloren për parandalimin e ngacmimeve dhe kodin etik kanë për detyrë t'i kërkojnë personit përkatës që të ndalojë sjelljen e padëshirueshme edhe e kanë për detyrë të informojnë palën e prekur për të drejtën e paraqitjes së denoncimit dhe ta drejtojnë në Task Forcë për të marrë më shumë informata për procedurën.

Denoncimi i rrejshëm: Denoncimi i rrejshëm është vepër penale e ndëshkueshme me ligjet e Republikës së Kosovës. Ndaj personit/ave përgjegjës për denoncim të rrejshëm do të inicohet procedurë disiplinore pranë Këshillit të Etikës të UP-së.

Komisioni Disciplinor: Fakulteti themelon komisionin disiplinor sipas rregullativës në fuqi, tek i cili mund të raportohen shqetësimet për mbrojtjen e stafit dhe studentëve. Anëtarët e këtij komisioni janë të njohur për të gjithë studentët dhe bashkëpunëtorët si dhe reflektojnë barazi gjinore në përfaqësim. Komisioni është i përgatitur të reagojë në mënyrë të përshtatshme në situata krize. Qëllimi kryesor i komisionit është të sigurojë vlerësime për rastet e denocuara. Komisioni Disciplinor me rastin e pranimit të një denoncimi, formal ose joformal obligohet t'i trajtojë ato sipas rregullores për punën e këtij komisioni apo në rastet e caktuara për ngacmimet seksuale duhet të vendos kontakt brenda ditës me zyrtarin e emëruar të universitetit për mbrojtje nga ngacmimi.

RAPORTIMI

Sesionet informuese: Task Forca planifikon sesione Informative për të informuar stafin dhe studentët për procesin e raportimit dhe për hapat që ndiqen pas denoncimit/ raportimit të një incidenti dhe trajnime për stafin përgjegjës për pranimin e denoncimeve mbi menaxhimin e rasteve të raportuara dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjithë individëve të përfshirë.

Sigurimi i Raportimit- Fakulteti krijon një Linje të Veçantë të Raportimit (përmes adresës elektronike), me qasje të lehtë për të raportuar diskriminimin ose abuzimin në mënyrë anonime.

Rëndësia e Konfidencialitetit: Konfidencialiteti është thelbësor kur trajtohen rastet e diskriminimit dhe ngacmimit; çdo informacion duhet të trajtohet me kujdes. Çdo student ose person tjetër që jep informacion për ngacmimin duhet të jetë i vetëdijshëm se informacioni do të ndahet vetëm me ata që janë të autorizuar të kenë qasje në të, si Komisioni Disciplinor dhe Task Forca e themeluar në nivel të Fakultetit.

Mbështetje për Raportuesit: Studentët që janë subjekt i diskriminimit/ ngacmimit dhe studentët që bëjnë raportimet mbështeten nga Fakulteti përmes Qendrës Këshilluese. Një person i akuzuar për diskriminim ose ngacmim të stafit ose studentëve merr një dëgjim të drejtë, duke siguruar që procesi të jetë i drejtë dhe transparent.

Të gjitha format e diskriminimit ose ngacmimit ndaj studentëve dhe stafit trajtohen seriozisht, pa përjashtim, në të gjitha programet e Fakultetit të Edukimit, dhe reagimi bëhet me kohë dhe në mënyrë të drejtë. FEdu siguron që gjithmonë të ketë një përgjigje ndaj denoncimit. FEdu avokon që në çdo rast potencial të ndiqet një procedurë transparente dhe e drejtë.

Fokusi në mbrojtjen e individëve: Në të gjitha rastet e dyshuara ose të vërtetuara, fokusi është në mbrojtjen e individëve të prekur. Në të njëjtën kohë, ofrohen masa këshilluese dhe garantohet mbrojtja e të gjithë personave të cënuar. Studentët që preken nga këto situata, do të marrin këshillimin dhe mbështetje të nevojshme përmes Qendrës Këshilluese të UP-së, përderisa për stafin do të ofrohen referime të përshtatshme nga vet Qendra.

Procedurat e raportimit: FEdu përcakton procedurat që duhet të ndiqen për nivele të ndryshme të ngacmimit konform rregulloreve në fuqi.

Menaxhimi i Informacionit: Ka një menaxhim të qartë, me një person përgjegjës për menaxhimin e informacionit dhe komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm në lidhje me incidentet e ngacmimit ndaj stafit dhe studentëve. Ky person mbështetet nga Task Forca në komunikimet që ka me publikun.

Vendimet e shpejta: Vendimet dhe veprimet merren shpejt për të siguruar një reagim efektiv.

Regjistrimi i Rasteve: Regjistra të shkruar të të gjitha rasteve të raportuara dhe përfundimeve të tyre ruhen në Fakultet.

Denoncimi publik i rasteve të komunikimeve joprofesionale: Rastet e komunikimeve joprofesionale e komunikimeve që kualifikohen si ofendime do të diskutohen edhe në forume dhe mekanizma të fakultetit, në mënyrë transparente, dhe në emër të reagimit dhe vetëdijësimit të të gjithëve. Tërheqja publike e vërejtjes është mekanizmi i parë në këtë proces.

Zbatimi i kësaj politike kërkon përkushtim nga të gjithë anëtarët e Fakultetit të Edukimit, për të garantuar një mjedis të sigurt, të barabartë dhe përfshirës.

Fakulteti është i angazhuar të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe adresuar çdo formë diskriminimi dhe abuzimi.

5. Mbështetja dhe Burimet

Fakulteti i Edukimit do të sigurojë resurse të mjaftueshme për mbështetjen e studentëve dhe stafit, duke përfshirë shërbime këshilluese dhe psikologjike për viktimat e diskriminimit dhe abuzimit. Po ashtu, do të krijohen materiale dhe udhëzues për stafin dhe studentët, që t'i drejtohen këtyre burimeve në raste nevojë. Trajnimet dhe sesionet e ndërgjegjësimit do të mbështeten në mënyrë të vazhdueshme për të përmirësuar njohuritë dhe kapacitetet për menaxhimin e këtyre çështjeve.

6. Monitorimi dhe Rishikimi

Politika dhe praktikat e zbatimit do të monitorohen në mënyrë të rregullt nga Task Forca për të siguruar efektivitetin e tyre. Task Forca do të mbledhë të dhëna mbi rastet e raportuara, do të analizojë rezultatet e reagimit dhe do të rekomandojë përmirësime të vazhdueshme. Monitorimi do të përfshijë gjithashtu feedback-un nga studentët dhe stafi për të përshtatur politikat sipas nevojave të reja dhe standardeve më të mira ndërkombëtare.

7. Përfundim

Kjo politikë synon të sigurojë një mjedis të sigurt, përfshirës dhe të drejtë për të gjithë studentët dhe stafin në Fakultetin e Edukimit. Nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse që përfshin ndërgjegjësimin, parandalimin, raportimin dhe reagimin, Fakulteti do të mbrojë dinjitetin dhe të drejtat e të gjithë pjesëmarrësve në komunitetin arsimor. Zbatimi i kësaj politike pritet të ndihmojë në vetëdijësimin se të gjithë jemi përgjegjës, jo vetëm për veprimet individuale por edhe për kontributin dhe përkushtimin aktiv për mbrojtje të të gjithë anëtarëve të Fakultetit dhe për rritje të cilësisë së punës dhe mjedisit ku punojmë.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I EDUKIMIT

info@uni-pr.edu
edukimi.uni-pr.edu

gendrakeshilluese@uni-pr.edu

www.edukimi.uni-pr.edu

+ 383 38 229 201
